



Education for Development and Cultural Outreach

EDUCATION FOR DEVELOPMENT
AND CULTURAL OUTREACH

EDUKIMI PËR ZHVILLIM
DHE SHTRIRJE KULTURORE

EDUCO

RAPORTI VJETOR 2024

RR. ZAHIR PAJAZITI NR.100, 20000, PRIZREN, KOSOVË
INFO@OJQEDUCO.ORG / WWW.OJQEDUCO.ORG



Aktiviteteve të organizuara **27+**

Numri i projekteve të realizuara: **6**

Trajnimeve dhe workshopeve të mbajtura: **7**

Konferencave dhe forumeve ku EDUCO ka marrë pjesë: **3**

Numri i aktiviteteve për trashëgiminë kulturore: **5**

Numri i aktiviteteve për fuqizimin e komuniteteve: **4**

Numri i eventeve mediatike dhe promovuese: **4**

Numri i bashkëpunimeve me shkolla dhe organizata: **10+**

Qytetete ku janë realizuar aktivitete:

(Prizren, Mamusha, Dragash, Ferizaj, Prishtinë)


MOMENTE KYÇE TË VITIT 2024:

- Ngritja e kapaciteteve në zyret tona
- Përfitues të projektit nga Europa Nostra për Funkcionalizimin e Muzeut të Hidroelektranës
- Jemi shpallur në vend të dyte me idenë nga programi KIST+
- Akademia Rinore Kundër Diskriminimit, në Bashkëpunim me OJQ Durmish Aslano.
- Organizimi i KONTUR 2024
- Angazhimi në trashëgiminë kulturore përmes vizitave dhe aktiviteteve me shkolla.
- Bashkëpunime të suksesshme me DokuFest, KEC, QRTK Prizren, dhe Komunën e Prizrenit.
- Partneritete të Erasmus+

SHTËPITË SHKOLLA - PRIZREN

30 Janar 2024

Në bashkëpunim me
Drejtorinë e Arsimit të
Komunës së Prizrenit,
Space SyntaKs dhe EDUCO
ka identifikuar dhe
dokumentuar të gjitha
shtëpitë që shërbyen si
shkolla në këtë komunë, të
dhëna të cilat janë
digjitalizuar në platformën
www.shtepiteshkolla.org.



Rreth 3000 shtëpi në Kosovë shërbyen si shkolla
përgjatë viteve 1990-1999.

Deri më tani, platforma ka identifikuar shtëpitë për
Komunën e Prishtinës, Gjakovës, Ferizajt dhe Prizrenit,
dhe në vazhdim do të plotësohet edhe me të dhëna nga
komunat tjera.

VIZITË KULTURORE

14 Shkurt 2024

EDUCO në bashkëpunim me shkollën fillore “Loyola” kemi organizuar një vizitë kulturore në monumentet e Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, ku nxënësit janë njoftuar afër me historinë e vendit tonë dhe vlerat tona të pasura kulturore.




NGRITJA E KAPACITETEVE

1 Prill 2024

Kemi krijuar edhe dy hapësira tjera të cilat mund të shfrytëzohen për aktivitete të ndryshme si p.sh:

- Trajnime
- Takime
- Punëtori
- Tryezë e rrumbullakët
- Mini konferenca
- Hapësirë për aktivitete tjera etj.




VENDOSJA E SENZORIT

1 Prill 2024

EDUCO ka vendosur Senzorin që bën matjen e Kualitetit të Ajrit . FLOSSK Free Libre Open Source Software Kosova i ka dhuruar zyrës së EDUCO një Senzor i cili bën matjen e pastërtisë dhe kualitetit të ajrit, temperaturës, shpejtësinë e erës dhe propabilitetin e shiut.

Senzori është vendosur në hapësirat e EDUCO, pra në rrugën Hadi Kantarxhiu dhe bën matjen konstante 24/7.



PËRSHËNDESIM PRANVERËN

27 Prill 2024

Me lumturitë e kësaj bote, fëmijët, po krijojmë punime të bukura dhe kreative për të përshëndetur stinën e bukur të Pranverës.

Së bashku me mësuesen Suzana Shkurti dhe NGO "Durmish Aslano", fëmijët e gëzuar nga qyteti i bukur i Prizrenit, organizuan aktivitetin e krijimit të luleve nga materiale të ripërdorura për të simbolizuar stinën e luleve, pra Pranverën.



SHËNIMI I DITËS NDËRKOMBËTARE TË MUZEVE

18 Maj 2024

EDUCO ka organizuar vizita me nxënës dhe qytetarë në Muzetë e qytetit të Prizrenit, ato në Kompleksin Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe Muzeun Arkeologjik të Rajonit të Prizrenit - Sahat Kulla.

Marrë parasysh që Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Prizren çdo vjet për nder të kësaj dite, i hap dyert e Muzeve dhe ofron vizitorëve hyrje falas tërë ditën.



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

18 Maj 2024

Me rastin e shënimit të 18 majit, Ditës Ndërkombëtare të Muzeve, Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren dhe OJQ Educo kanë nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi për të realizuar projektin "Zhvillimi i Metodave Inovative të Mësimit për Restaurimin e Artefakteve Etnografike në rajonin e Prizrenit".



SFIDËS SË TRANSFORMIMIT DIGJITAL SHOQËROR NGA PROJEKTI KIST+

23 Maj 2024

EDUCO në bashkëpunim me Grupin Medial të shkollës fillore "SHFMU "Fetah Sylejmani" Dragash" pas realizimit të sfidës së Transformimit Digjital Shoqëror nga projekti KIST+, ku morrën pjesë 12 shkolla nga komuna të ndryshme të Kosovës, pas vlerësimit final arritën të marrin vendin e dytë. Shkolla fituese, pra ajo në vendin e dytë "Fetah Sylejmani" u shpërblye me një çmim me shumë të parave prej 700€.

Nga sfida kemi realizuar një aktivitet që është përcjellur me një video të shkurtër përmbledhëse.



BASHKËBISEDIM PËR DRAFTIN E PARË TË PARKUT TË BANESAVE

3 Qershor 2024

EDUCO së bashku me banorët të banesave të një pjese të lagjes Lakuriq kanë organizuar takimin e parë për bashkëbisedim për draftin e parë të parkut të banesave. Gjatë këtij takimi janë marrë kërkesat, nevojat dhe idetë për rifunksionalizimin e hapësirës publike pra të parkut të banesave të Lakuriqit. Misioni i EDUCO është që në çdo proces vendimmarrës të ketë gjithëpërfshirje sociale.



PËRZGJEDHUR PËR FINANCIM NË KUADËR TË EUROPEAN HERITAGE HUB

26 Qershor 2024

Projekti ynë synon që gjatë katër muajve të rivitalizojë trashëgiminë kulturore të Prizrenit, duke u fokusuar veçanërisht në Muzeun e Hidroelektranës së Prizrenit. Një ekspert nga vendet fqinje do të ofrojë trajnime të specializuara për anëtarët e stafit mbi aspektet e muzeut, menaxhimin, duke përfshirë teknikat e kurimit, gatishmërinë e emergjencave dhe përgatitjen e strategjisë si dhe historinë unike dhe rëndësinë e Muzeut e Hidroelektranës së Prizrenit.

Misioni i EDUCO është që në çdo proces vendimmarrës të ketë gjithëpërfshirje sociale.



ORGANIZIMI I KONTUR 2024

Përgatitjet për KonTur 2024 filluan në mars të vitit 2024 për të siguruar që ngjarja të përkojë me Ditën Botërore të Turizmit më 27 shtator. Gjatë kësaj periudhe, ekipi organizativ i EDUCO-s ndërmori hapat kyçe.

Tema kryesore, “Kon-Tur-bulenca,” u zgjodh për të adresuar sfidat e turizmit masiv në Prizren dhe për të promovuar një qasje të balancuar dhe të qëndrueshme për menaxhimin e fluksit të lartë të turistëve. Diskutimi përfshiu sfida si ruajtja e identitetit unik të qytetit, mbrojtja e mjedisit dhe e trashëgimisë kulturore, si dhe ruajtja e autenticitetit të përvojës për vizitorët dhe komunitetin lokal.

Temat kryesore të trajtuara përfshinin:

- Kërkimin e një ekuilibri mes turizmit të qëndrueshëm dhe masiv.
- Strategjitë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe mbrojtjen e ambienteve historike.
- Rëndësinë e përfshirjes së komunitetit lokal dhe biznesit në planifikimin e turizmit të ardhshëm.
- Ndikimin ekonomik të turizmit në qytetin e Prizrenit dhe potencialin e tij për të ndihmuar zhvillimin ekonomik afatgjatë.



Hapja solemne u mbajt më 27 shtator 2024 në Kino Plato me moderimin e Sejnur Veshall, ku u shfaq një film i shkurtër prezantues për konferencën. Pas fjalimeve të rastit të mbajtura nga drejtori i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, z. Ramadan Tarashaj, dhe drejtori i EDUCO-s, z. Enis Shkurti, pati një event kulturor me këngëtarën Edona Reshitaj dhe bandën e saj, të ndjekur nga një performancë DJ.



AKADEMIA RINORE KUNDËR DISKRIMINIMIT

Dhjetor 2024

Në bashkëpunim me OJQ Durmish Aslano organizuam Akademinë Rinore Kundër Diskriminimit në dy komuna: Mamusha dhe Prizren.

Programi kishte për synim edukimin dhe ndërgjegjësimin e të rinjve mbi rëndësinë e barazisë, të drejtave të njeriut dhe bashkëpunimit ndërkomunitar.

Kohëzgjatja: 4 ditë

- U zhvilluan diskutime, seminare dhe detyra kolektive, duke krijuar një hapësirë të sigurt për reflektim mbi rolin e të rinjve në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
- Në ditën e katërt, pjesëmarrësit vizituan Prizrenin, një qytet shembull për harmoninë multietnike, ku eksploruan Trashëgiminë Kulturore.
- Akademia përfundoi me një program kulturor në shkollë, ku nxënësit prezantuan temat e trajtuara përmes poezisë, esesë, këngës, pikturës, fotografisë dhe videos.
- Të gjithë pjesëmarrësit u çertifikuan për angazhimin e tyre.

AKADEMIA RINORE KUNDËR DISKRIMINIMIT




Dhjetor 2024



FALENDERIME



**DOKU
FEST**



NA NDJEKNI:

ojqeducu.org

kontur.ojqeducu.org



[ojq.educo](https://www.instagram.com/ojq.educo)



[ojq.educo](https://www.facebook.com/ojq.educo)



[@ojq.educo](https://www.youtube.com/@ojq.educo)

[linkedin.com/company/ojqeducu](https://www.linkedin.com/company/ojqeducu)

[tiktok.com/@ojq.educo](https://www.tiktok.com/@ojq.educo)

open.spotify.com/ojq.educo